

**Prof. Hamit BEQJA**  
**Akademik**  
**KRYETAR NDERI**

**BORDI AKADEMIK**

Bordi Akademik është organi më i lartë shkencor i Institutit të Sociologjisë, si dhe organi më i lartë vendimmarrës midis dy asambleve të tij. Kryetari i Bordit Akademik është autoriteti më i lartë shkencor i Institutit të Sociologjisë.

*Statuti i Institutit të Sociologjisë, neni 11*

**Servet PËLLUMBI**  
**Kryetar i Bordit Akademik**

**Nora MALAJ**  
**Nënkryetare e Bordit Akademik**

**Anëtarë të Bordit Akademik**

**Alfred UÇI (Akademik)**

**Tonin ÇOBANI**

**Enis SULSTAROVA**

**Silvana HAXHIAJ**

**Gezim TUSHI**

**Lekë SOKOLI**  
**Drejtor Ekzekutiv**

**Fatos TARIFA**  
**Drejtor për Marrëdhëniet Ndërkombëtare**

**Sejdin CEKANI**

**Drejtor i Botimeve;**  
**Kryeredaktor i revistës “Politika & Shoqëria”**

**Hamit BEQJA** ka studiuar për psikologji e pedagogji në Institutin Pedagogjik të Moskës, në periudhën 1949 – 1953 dhe për rreth 40 vjet, duke filluar nga viti 1954 e deri sa doli në pension, më 1993, ai ka qenë pedagog, kryesisht në Universitetin e Tiranës. Për më shumë se ½ shekulli është marrë krijimtari socio-psikologjike e socio-pedagogjike. Ka botuar mbi dyzet libra të shkencave sociale dhe rreth 500 artikuj në gazeta për arsimin, historinë, kulturën, pedagogjinë, psikologjinë (sidomos atë sociale edhe etnike), sociologjinë (sidomos atë të kulturës e të edukatës) etj. Veprimtarinë shkencore e botuese ai e ka shtjelluar në librin “Gjurmë jetë, shkrime autobiografike (2004), ideja qendrore e të cilit është vetjakësia e spikatur dhe e ndërlikuar e jetës së tij. Ndër botimet e tij përmendim: *Psikologjia* (1959, 1963, 1965); *Historia e pedagogjisë* (1965); (1965); *Rreth disa kontradiktave në metodat e mësimin dhe të*

edukimit (1970); *Mbi karakterin kombëtar të edukates* (1979); *“Rreth edukatës qytetare”* (1981); *“Teoria dhe metodika e edukates”* (1985); *“Si sillemi, ç’zakone ndjekim?”* (Rreth edukatës qytetare, 1986); *“Kë edukojmë, si edukojmë?”* (Bashkëbisedime për edukatën, 1987); *“Edukata me syrin e popullit”* (1988); *“Për rininë dhe me rininë”* (1991); *“Edhe engjëlli, edhe djalli janë brenda tek i gjalli”* (1995); *“Dashuria, seksi, studentët e mi”* (1999); *“Periudha e tranzicionit demokratik dhe psikologjia e shqiptarëve”* (2001); *“Divorci - vrojtimet e refleksione* (bashkautor me dr. Lekë Sokoli, 2001); *“Përgjigje letrave rinore”* (2001) etj. Për veprimtarinë shkencore e botuese, Hamit Beqja, në vitin 1970 ka marrë titullin “Profesor”, në vitin 1984 i është dhënë titulli “Mësues i Popullit”, në vitet ‘80-të ka fituar dy çmime të Republikës dhe në vitin 1988 është zgjedhur anëtar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë. Nga ky vit ai mban titullin “Akademik”. Asambleja e Institutit të Sociologjisë, më 21 nëntor 2006 e ka zgjedhur Kryetar NDERI të tij.

**Servet PËLLUMBI** ka kryer studimet e larta për filozofi, në San Petërsburg, në vitin 1960. Për më se 30 vjet, nga viti 1960 e deri në vitin 1991, ka qenë pedagog i filozofisë dhe sociologjisë teorike në shkollat e larta, kryesisht në Universitetin e Tiranës. Në vitin 1967 ka marrë titullin shkencor “Docent” ndërsa në vitin 1989 ka mbrojtur doktoranturën në fushën e sociologjisë së përgjithshme. Është autor ose bashkautor i disa teksteve për shkollat e larta, i disa monografive, i *“Fjalorit të filozofisë”*, në dy edicione, si dhe i një numri të madh artikujsh shkencorë e studimesh të botuara në revista shkencore brenda e jashtë vendit. Librat e tij më të fundit janë: *Dritëhijet e tranzicionit* (2000), *Të mendosh ndryshe* (2001), *Gjurmime sociologjike* (2002), *Sprovë në sociologjinë politike* (2002); *Edhe politika do moral* (2005). Është zgjedhur zëvendëskryetar i Partisë Socialiste të Shqipërisë në kongresin e themelimit të saj, në qershor të vitit 1991. Ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në disa legjislatura, nga viti 1992; ka bërë pjesë në Komisionin parlamentar të Punëve të Jashtme, si dhe atë të Arsimit, Kulturës e Shkencës dhe Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, deri në zgjedhjet e 3 korrikut 2005. Është një ndër bashkëthemeluesit e Institutit të Studimeve Politike e Sociale (ISPS) dhe President i tij, si dhe kryetar i bordit botues të revistës *Politika & Shoqëria*. Bordi Akademik i dalë nga Asambleja e Institutit të Sociologjisë, datë 21 nëntor 2006 e ka zgjedhur atë Kryetar të tij.

**Alfred Uçi** ka kryer studimet e larta në fakultetin e Filozofisë të Universitetit “Llomonosov” të Moskës, në vitet 1949-1954. Më pas ka punuar si pedagog në Institutin e Lartë Ekonomik të Tiranës. Që me krijimin e Universitetit të Tiranës ai ka qenë pedagog i estetikës dhe i filozofisë në fakultete të ndryshme të tij. Në vitin 1970 iu dha titulli “profesor”. Ka qenë, gjithashtu, drejtor i Institutit të Kulturës Popullore pranë Akademisë së Shkencave (vitet 1979-1987) dhe kryetar i Komitetit të Kulturës dhe Arteve (1987-1990). Ka marrë pjesë në kongrese, konferenca e simpoziume shkencore ndërkombëtare në Sofje, Athinë, Ankara, Beograd, Prishtinë, Vjenë, Itali, Suedi, Francë etj. Ka shkruar një numër të madh artikujsh, referatesh e kumtesash me tematikë nga fusha e filozofisë, sociologjisë, estetikës, etnografisë, folkloristikës, kritikës letrare etj. Ai ka shkruar e botuar librat: *Estetika, jeta, arti* (1970), *Probleme të estetikës* (1976), *Labirintet e modernizmit* (1978), *Probleme të estetikës* (1980), *Mitologjia, folklori, letërsia* (1982), *Çështje teorike të estetikës dhe të kulturës* (1986), *Estetika – Vëllimi I, II, III* (vitet 1987-1988), *Shekspiri në botën shqiptare* (1996), *Dostojevski në kohën tonë* (1997), *Ferrparaajsa Danteske* (1998), *Prometeu dhe Hamleti* (Botuar në greqisht, në Athinë, 1998), *Grotesku kadarean* (1999), *Estetika e groteskut – Teoria dhe historia* (2001), *Estetika në folklor dhe në letërsinë shqipe* (2001), *Paradigma të ndërgjegjes shoqërore - estetikë filozofike e politike* (2001) etj. Prof. Alfred Uçi është anëtar i Akademisë së Shkencave. Asambleja e Institutit të Sociologjisë, më 21 nëntor 2006 e ka zgjedhur Anëtar të Bordit Akademik.

**Enis SULSTAROVA** ka lindur në Tiranë në vitin 1978. Ka kryer studimet universitare në degën e sociologjisë, pranë Middle East Technical University në Ankara. Në të njëjtin universitet ka kryer edhe studimet pasuniversitare, në degën e shkencave politike dhe të administrimit publik. Aktualisht punon pranë *Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim* në Tiranë, si kordinator i projekteve rajonale. Ai është autor i disa artikujve studimorë të botuar në organe të ndryshme, brenda dhe jashtë Shqipërisë, si dhe i librave *Ligjërimi nacionalist në Shqipëri* (Afërdita, 2003) e *Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja* (Botimet Dudaj, 2006). Është pedagog i jashtëm i sociologjisë dhe i shkencave politike pranë Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës dhe bashkëpunëtor shkencor i Institutit të Studimeve Politike e Sociale (ISPS). Asambleja e Institutit të Sociologjisë, më 21 nëntor 2006 e ka zgjedhur Anëtar të Bordit Akademik.

**Silvana HAXHIAJ** është asistente e programeve Anti-trafiking, pranë Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), në Tiranë. Ajo është diplomuar për shkencat pedagogjike, në vitin 1989, si dhe ka fituar një çertifikatë specializimi, në Punë Sociale, në vitin 1995. Për më shumë se 11 vjet, ajo ka punuar me organizatat ndërkombëtare që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri, duke u përqëndruar kryesisht në ndihmën ndaj grupeve të rrezikuara dhe në nevojë, siç janë femijët me probleme të zhvillimit të vonshëm mendor, fëmijët dhe të rinjtë jetimë dhe të braktisur, personat viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore etj. Gjatë periudhës 2005 – 2006, ajo ka qenë kordinatore projektit rajonal “Mbi parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, nëpërmjet aktiviteteve edukative dhe ngritjes së kapaciteteve në shkollat dhe organizatat e shoqërisë civile”, të Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM), në të cilin janë përfshirë gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Ky project është zbatuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë dhe ministrinë respektive të vendeve të rajonit.

**Gëzim TUSHI** ka mbaruar studimet në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave politike dhe Juridike në vitin 1976. Në vitin 1983, ka bërë specializimin pasuniversitar një vjeçar për Psikologji dhe Pedagogji në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Ka punuar si mësues i sociologjisë në shkollat e mesme, drejtor gjimnazi, inspektor i kulturës, drejtor i Teatrit dhe Estradës profesioniste në Vlorë, gazetar etj., si dhe politikan profesionist (vitet 1991-96). Më pas ka punuar në shërbimin social shtetëror si drejtues në nivele të ndryshme. Aktualisht është drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimit Social. Është kualifikuar në shumë trainime, udhëtime studimore, për probleme social-psikologjike etj., në ShBA, Zvicër, Turqi, Bullgari, Rumani, Itali, Britani e Madhe, Irlandë, Hungari, Maqedoni. Është bashkautor në hartimin e disa strategjive të shërbimit social si dhe për hartimin e dokumentit të Standarteve të Përgjithshme të Shërbimit Social. Ka punuar në Konferencën e vendeve të Europës Juglindore, organizuar nga ILO në Budapest, Raportin Nacional për “Praktikat më të mira të shërbimit social” në 2003 (i botuar). Ka marrë pjesë në konferenca kombëtare e ndërkombëtare. Në librat e botuar të tij përmendim: “Politika, fatalitet i kohës” (1998), “Fëmijët e rrugës” (bashkëautor, 2000), “Kultura e familjes në fshat” (2002), “Probleme dhe dilemma sociale” (2006), “Politika dhe qytetari” (2007). Ka zhvilluar sidomos sociologjinë publike, përmes analizave në organe të ndryshme të shtypit dhe ka në proces botimi dy libra të rinj: “Shoqëria civile” dhe “Politika dhe shoqëria”. Është pedagog i jashtëm në degën e pedagogjisë së specializuar në Universitetin “Ismail Qemali”. Është anëtar i Bordit Akademik të Institutit të Sociologjisë.

**Lekë SOKOLI** ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Inxhinierisë, dega mekanike dhe, më pas, si fakultet i dytë, në atë të Shkencave Politike e Juridike, dega filozofi, pranë Universitetit të Tiranës. Prej rreth 20 vjetësh ai është marrë me studime, botime e mësimdhënie në fushën e sociologjisë. Në vitin 1991 fitoi gradën *doktor i shkencave sociologjike*. Ka qenë bashkëpunëtor shkencor i Sektorit të Filozofisë të Universitetit të Tiranës (1986-1990), një ndër bashkëthemeluesit e Shoqatës Sociologjike Shqiptare (dhjetor 1990), si dhe nëndrejtor i Qendrës së Re të Studimeve Sociologjike (1993-1999), etj. Është autor i mjaft studimeve e artikujve shkencorë të botuar në Shqipëri e në vende të tjera. Është bashkëthemelues dhe bashkëbotues i revistës ndërkombëtare *Sociological Analysis (SA)*, botuar në Karolinën e Veriut, SHBA (1998-1999). Nga veprimtaria studimore e botuese e tij veçojmë librat: *Sociologjia* (1997), *Droga - historia, përkufizime, klasifikimi, efektet, terapia* (1999), *Themeluesit e sociologjisë* (2000); *Droga-ribotim i përshtatur për nivelin shkollor* (2000), *Divorci – vrojtime e refleksione*, bashkautor me prof Hamit Beqja, akademik (2001), *Demokracia dhe problemet sociale*, Studime sociologjike, I (2002), *Interesat dhe harmonizimi i tyre*, Sociologji e punës, I (2003), *Prostitucioni si profesion*, vështrim sociologjik (2006); *Sociologjia dhe jeta e përditshme*, Sociologji publike, I (2006); *Trafikimi, rasti i Shqipërisë*, bashkautor me dr. Ilir Gëdeshi (2006); *Analiza sociologjike* (2006); *Mendimi sociologjik shqiptar, 1986-2006, bibliografi* (bashkautor me dr. Fatos Tarifa). Është drejtor ekzekutiv i *Institutit të Studimeve Politike e Sociale (ISPS)* dhe drejtues kërkimesh (part time) pranë Qendrës së Studimeve Ekonomike e Sociale (QSES). Ai është zgjedhur drejtor ekzekutiv i Institutit të Sociologjisë nga Asambleja e tij e datës 21 nëntor 2006.

**FATOS TARIFA** ka qenë ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiptotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Hollandës (vitet 2000-2001) dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, deri në vitin 2005. Ai ka fituar një Ph.D. të dytë në sociologji në University of North Carolina, Chapel Hill, në SHBA dhe një doktoranturë në shkencat politike në Universitetin e Tiranës. Ka qenë dekani i parë i Fakultetit të Sociologjisë e Filozofisë (1991-92) dhe përgjegjës i sektorit shkencor të sociologjisë në Universitetin e Tiranës (1990-1993). Më 1992 ai ishte Fulbright Fellow në University of North Carolina, Chapel Hill, ndërsa më 1993-94 Senior Research Fellow në Institute of Social Studies, Hagë. Më 1993 dr.Tarifa themeloi Qendrën e Re të Studimeve Sociologjike në Tiranë dhe ishte drejtor i saj deri më 1998. Më 1998, së bashku me dr. L. Sokolin, themeluan revistën akademike ndërkombëtare *Sociological Analysis*, e cila botohej nga Copytron Academic Publishers, Chapel Hill, USA dhe ishte kryeredaktor i saj. Dr. Tarifa ka dhënë mësim në disa universitete të SHBA-ve, si dhe në Hollandë. Ai është autor dhe redaktor i 14 librave dhe i një numri të madh artikujsh të botuar në revista të ndryshme akademike ndërkombëtare. Ndër librat e tij të fundit përmendim: *Social Problems of Transition* (The Hague 2003), *The Balkans: A Mission neither Accomplished nor Impossible* (The Hague: 2002). *The Breakdown of State Socialism and the Emerging Post-Socialist Order* (The Hague: 2001), *Culture, Ideology and Society* (The Hague: 2001), *The Quest for Legitimacy and the Withering Away of Utopia* (The Hague 2001), and *The First Decade and After: Albania's Democratic Transition and Consolidation in the Context of Southeast Europe* (me M. Spoor; The Hague, 2000); *Mendimi sociologjik shqiptar, 1986-2006, bibliografi*, bashkautor me dr. Lekë Sokoli (2006). Asambleja e Institutit të Sociologjisë, datë 21 nëntor 2006, e ka zgjedhur drejtor për Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

**Sejdi CEKANI** ka kryer studimet e larta në degën gjuhë-letërsi shqipe, në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës, në vitet 1979-1983. Në periudhën 1983 e deri në nëntor 1996 ka punuar gazetar dhe redaktor në të përditshmen “Zëri i popullit”, ndërsa në periudhën nëntor 1996 - dhjetor 1997 - redaktor në shtëpinë botuese “Onufri”. Nga marsi

1998 - mars 2001, ka qenë redaktor përgjegjës për botimet sociologjike, artistike dhe përkthimet në Shtëpinë Botuese të Ushtrisë, ndërsa në vitet 2001- 2005, kryeredaktor i shtëpisë botuese “DUDAJ”. Nga gushti 2005 e në vijim ai është kryeredaktor i Shtëpisë Botuese “Max”. Në vitet 1996-1998 ka qenë pedagog i jashtëm pranë katedrës së letërsisë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit. Si bashkëpunëtor i jashtëm ka qenë redaktor letrar i revistës “Spektër” dhe i gazetës “Shekulli” për një periudhë dyvjeçare (1998-2000). Ka bashkëpunuar si redaktor i jashtëm me shtëpitë botuese *Rinia 2000*, *Phoenix*, *Extra* e *Konica* në Tiranë, si dhe me Shtëpinë Botuese *Vatra* në Shkup. Në vitet 1996 dhe 1998 ka ndjekur kurse kualifikimi, organizuar nga Instituti shqiptar i Medias dhe Shoqata e Gazetarëve të Danimarkës. Në vitin 1997 është vlerësuar me diplomë nderi nga fondacioni “Friedrich Hebert”, për shkrimet e botuara në shtypin e përditshëm gjatë periudhës 1991-1996. Nga janari i vitit 2000 e në vijim ka qenë drejtor i botimeve të Institutit të Studimeve Politike e Sociale dhe kryeredaktor i revistës shkencore “*Politika & shoqëria*”, organi i Institutit të Studimeve Politike e Sociale dhe, nga tetori i vitit 2006, organ i përbashkët me Institutin e Sociologjisë. Në nëntë vjetët e fundit ka redaktuar mbi 200 libra të ndryshëm (artistikë, shkencorë sociologjikë, politikë etj). Është ndër anëtarët themelues të Institutit të Sociologjisë.